


**AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE
"C&S CONSTRUCTION" SH.P.K**




Ne baze te ligjit 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe te ligjit 7667 dt.28.01.1993 "Per regjistrin tregtar" Z.Isuf SUKAJ lidh kete kontrate :

FORMIMI I SHOQERISE

Neni no. 1

Formohet shoqeria e quajtur "C&S CONSTRUCTION" sh.p.k me ortak te vetem Z.Isuf SukajI lindur ne Kavaje me 1931 ne Tirane ne adresen rruga "Stavri Vrinjau" pall.2,shk.3,ap.4 ,me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.



QENDRA E SHOQERISE

Neni no.2

Qendra e shoqerise do te jete ne qytetin e Kavajes perballe PTT Kavaje. Shoqeria mund te hapi dhe vendqendrim te tjera te dyta operative dhe filjale ne te gjithë territorin e vendit si dhe jashte tij, me miratimin e organeve kompetente dhe ne perputhje me legjislacionin e vendit ku do te hapen keto agjensi.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Neni no.3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike eshte e pakufizuar mbi 10 vjet dhe mund te zgjatet me vendimin dhe vullnetin e lire te paleve konform legjislacionit shqiptar ne fuqi.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni no.4

Objekti veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

Aktivitet ndertues dhe projektues sipas te gjitha kategorive te percaktuara ne licensen profesionale te drejtuesit teknik te shoqerise:

Per zbatim:

Kat.1 – Punime dheu,sistemime, tarracime terrenesh etj.

Kat.2 a- Prodhim materiale inerte ,rer,cakull,gure,mermer etj.

2/c-Prodhim elemente te parafabrikuara,betoni e b/armeje.

Kat.3 –a,b- Ndertime civile dhe ekonomike.

Kat.4/a – ndertim rruge kat.V,IV.

C -veshje me asfalto beton te rrugeve(ndertim mbishtresae) si dhe sistemim dhe asfaltim sheshe.

Kat.6/a - ndertim vepra arti te vogla deri ne 6m.

Kat.8/b - ndertime ujesjellessa dhe kanalizime.

8/c- Ndertime vepra kullimi,ujitje toke e impiante vaditese.
godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash etj.

Kat. 10/a- Rikonstruksione godinash civile e ekonomike,veshje fasadsh etj.

10/b- restaurimi I monumenteve te kultures.

Kat.14/a- Punime ne sip.e gjelberta,parqe,pyll parqe.

Per projektim :

Kat.1/b-Plane rregulluese qytetesh.

1/c-Plane rregulluese fshatrash e qendrash te banuara.

1/d-Studime pjesore urbanistike.

1/e-Plan vendosje objekte te vecanta.

Kat.2 -Projektues arkitekt

a- Projekttime ndertime civile ,industriale,turistike,bujqesore etj.der ne dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

b- Projekttime ndertime civile ,industriale,turistike,bujqesore etj.mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

c- Projektimi I objekteve sportive.

d- Projektim pejsazhi,(sistemime,lulishte,vepra arti,dekor etj.)

e- Projektim interierie,mobilje,pajisjesh,dizajn industrial.

Tregtimi me shumice dhe pakice I mallrave ushqimore ,industriale, elektrike, elektroshtepiake, pjese kembimi etj.

Tregtimi I prodhimeve te drurit ,pjesëve te kembimit per automjete, per llogari te vete shoqerise ose te te treteve.

Veprimtari ne fushen e zhvillimit te industries elektro-shtepiake, prodhimi I tyre , I pjesëve te kembimit , montimi I tyre , prodhimi dhe tregtimi I lendes se pare si dhe tregtimi I tyre Brenda dhe jashte vendit.

Tregtimi me shumice dhe pakice I mallrave bujqesore dhe blegtorale,perpunimi I tyre, tregtimi dhe prodhimi I bimeve medicinale, I plehrave kimike, I pesticideve dhe I cdo lloj kimikati tjeter qe perdoret ne bujqesi. Tregtimi I makinerive dhe montimi I tyre.


Veprimtaria ne fushen e industries se lehte, te rende, ushqimore, tekstile per prodhimin dhe tregtimin e mallrave industriale ne teresi, tregtimi I karburanteve dhe I vajrave lubrifikante me pakice.

Veprimtari ne fushen e transporteve te mallrave dhe pasagjereve Brenda dhe jashte vendit nga toka ,deti dhe ajri.

Hapje e agjensi komisionere, agjensi informacioni. Perfaqesimi I shoqerive te tjera shqiptare ose te huaja dhe marrja e ekskluzivitetit per fusha te ndryshme.

Marrja e ekskluzivitetit nga shoqeri te ndryshme Brenda dhe jashte vendit per prodhimin dhe shitjen e mallrave te ndryshme lidhja e kontratave me persona fizike ose juridike Brenda dhe jashte vendit,pjesemarrje ne tender dhe ankande te organizuar nga shteti ose persona te tjere per shitjen prodhimin e mallrave te shoqerise.

Ne cdo kohe shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj konform rregullave, ligjes si dhe vendimit te Asamblese se Ortakeve.



KAPITALI I SHOQERISE

Neni no.6

Kapitali I shoqerise eshte 100.000 leke. Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve.

ORGANET E SHOQERISE

Neni no.7

Shoqeria private drejtohet dhe administrohet nga vete ortaket e shoqerise dhe organet e saj:

1. Asambleja e Ortakeve
2. Administratori
3. Komisioni I Revizionit

Menyra dhe drejtimi I shoqerise jane te percaktuar ne Statusin e Shoqerise. I gjithe investimi I kesaj shoqerie eshte I mbrojtur nga shteti ne baze te ligjit "Mbi investimet e huaja".

Drejtues teknik I shoqerise dhe Administrator I saj eshte Z. Isuf Sukaj qe kryen te gjitha veprimet qe jane te lejuara nga ligji dhe te percaktuara ne Statutin e Shoqerise.


Neni no.8

Ne qofte se do te likujdohet shoqeria do te percaktohet nje komision likuidimi qe do te parashtroje nje bilanc likuidimi per miratim.

Neni no.9

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike eshte e pakufizuar mbi 10 vjet dhe mund te zgjatet me vendimin dhe vullnetin e lire te paleve konform legjislacionit ne fuqi.

ISUF SUKAJ



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 988 REP
NR 216 KOL

VERTETIM

Sot ne daten 19.02.2002 perpara meje noteres Mimoza Sadushaj, Notere prane Dhomes se Noterise Tirane, me adrese Rruga e Durresit, p 11, u paraqit personalisht Isuf Sukaj, banues ne Tirane, madhor me zotesi juridike per te vepruar i njohur prej meje personalisht, i cili nenshkroi aktin e mesiperme dhe une Noterja e vertetoj ate sipas ligjit.



MIMOZA SADUSHAJ
NOTERJA
TEL +294-959



STATUTI I SHOQERISE

"C&S CONSTRUCTION" SH.P.K.

Ne baze te ligjit 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe ligjit 7667 dt. 28.01.1993 "Per regjistrin tregtare" Z.Isuf Sukaj shpall si vijon me poshte

FORMIMI I SHOQERISE

Neni no.1

Formohet shoqeria e quajtur "C&S CONSTRUCTION" SH.P.K me ortake te vetem Z.Isuf Sukaj biri I Feridid I lindur ne Kavaje me 1931 bimes ne Tirane rruga "Stavri Vrinjau" pall 2,shk.3.ap.4,me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar

QENDRA E SHOQERISE

Neni no.2

Qendra e shoqerise do te jete ne qytetin e Kavajes perballe PTT Kavaje. Shoqeria mund te hapi dhe vendqendrim te tjera operative dhe filjale ne te gjithë territorin e vendit si dhe jashte tij me miratimin e organeve kompetente dhe ne perputhje me legjislacionin e vendit ku do te hapen keto agjensi.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Neni no.3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike eshte e pakufizuar mbi 10 vjet dhe mund te zgjatet me vendimin dhe vullnetin e lire te paleve konform legjislacionit shqiptar ne fuqi.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni no.4

Objekti I veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte :

Aktivitet ndertues dhe projektues sipas te gjitha kategorive te percaktuara ne licensen profesionale te drejtuesit teknik te shoqerise:

Per zbatim:

Kat.1 - Punime dheu,sistemime, tarracime terrenesh etj.

Kat.2 a- Prodhim materiale inerte ,rer,cakull,gure,mermer etj.

2/c-Prodhim elemente te parafabrikuara,betoni e b/armeje.

Kat.3 -a,b- Ndertime civile dhe ekonomike.

Kat.4/a - ndertim rruge kat.V,IV.

C -veshje me asfalto beton te rrugeve(ndertim mbishtresae) si dhe sistemim dhe asfaltim sheshe.

Kat.6/a - ndertim vepra arti te vogla deri ne 6m.

Kat.8/b - ndertime ujesjellessa dhe kanalizime.

8/c- Ndertime vepra kullimi,ujitje toke e impiante vaditese.


Kat.10/a - rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash etj.

10/b- restaurimi I monumenteve te kultures.

Kat.14/a- Punime ne sip.e gjelberta,parqe,pyll parqe.

Per projektim :

Kat.1/b-Plane rregulluese qytetesh.



1/c-Plane rregulluese fshatrash e qendrash te banuara.

1/d-Studime pjesore urbanistike.

1/e-Plan vendosje objekte te vecanta.

Kat.2 -Projektues arkitekt

a- Projektme ndertime civile ,industriale,turistike,bujqesore etj. deri ne dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

b- Projektme ndertime civile ,industriale,turistike,bujqesore etj.mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

c- Projektimi I objekteve sportive.

d- Projektim pejsazhi,(sistemime,lulishte,vepra arti,dekori etj.)

e- Projektim interierie,mobilje,pajisjesh,dizajn industrial.

Tregtimi me shumice dhe pakice I mallrave ushqimore ,industriale, elektrike, elektroshtepiake, pjese kembimi etj.

Tregtimi I prodhimeve te drurit ,pjeseve te kembimit per automjete, per llogari te vete shoqerise ose te te treteve.

Veprimtari ne fushen e zhvillimit te industries elektro-shtepiake, prodhimi I tyre , I pjeseve te kembimit , montimi I tyre , prodhimi dhe tregtimi I lendes se pare si dhe tregtimi I tyre Brenda dhe jashte vendit.

Tregtimi me shumice dhe pakice I mallrave bujqesore dhe blegtorale,perpunimi I tyre, tregtimi dhe prodhimi I bimeve medicinale, I plehrave kimike, I pesticideve dhe I cdo lloj kimikati tjeter qe perdoret ne bujqesi. Tregtimi I makinerive dhe montimi I tyre.

Veprimtaria ne fushen e industries se lehte, te rende, ushqimore, tekstile per prodhimin dhe tregtimin e mallrave industriale ne teresi, tregtimi I karburanteve dhe I vajrave lubrifikante me pakice.

Veprimtari ne fushen e transporteve te mallrave dhe pasagjereve Brenda dhe jashte vendit nga toka ,deti dhe ajri.

Hapje e agjensi komisionere, agjensi informacioni. Perfaqesimi I shoqerive te tjera shqiptare ose te huaja dhe marrja e ekskluzivitetit per fusha te ndryshme.

Marrja e ekskluzivitetit nga shoqeri te ndryshme Brenda dhe jashte vendit per prodhimin dhe shitjen e mallrave te ndryshme lidhja e kontratave me persona fizike ose juridike Brenda dhe jashte vendit,pjesemarrje ne tender dhe ankande te organizuar nga shteti ose persona te tjere per shitjen prodhimin e mallrave te shoqerise.

Ne cdo kohe shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj konform rregullave, ligjes si dhe vendimit te Asamblese se Ortakeve.

Neni no.5


Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ose te largoje ate, te rrise kapitalin e te tjera ndryshime sipas vendimeve qe do te marri Asambleja e Ortakeve.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni no.6

Kapitali shoqerise eshte 100000leke.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve.



DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni no.7

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut si dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne regjistrin tregtar ne Gjykatën e rrethit Tirane dhe pasi te marre licensen perkatese nga organi pergjegjes tatimor.

Neni no.8

Shoqeria vepron ne regjimin e pronës private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Pronaret e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

Organet e shoqerise jane :

- 1 – Asambleja e Ortakeve
- 2 – Administratori
- 3 – Komisioni I revizionit

ASAMBLEJA

Neni no.9

Organi me I larte I shoqerise eshte Asambleja e cila mbledhet nga cdo anetar I shoqerise qe perfaqeson te pakten 10% te kapitalit te shoqerise. Anetaret duhet te njoftohen 15 dite perpara dhe ne lajmerim duhet te jete shkruar vendi ,ora dhe problemet qe do te trajtohen.

N.q.s Asambleja nuk eshte mbledhur sipas rregullave te caktuara ajo mund te marre vendim kur cdo anetar I shoqerise eshte present dhe nuk kundërshton mbledhjen e Asamblese. Cdo anetar I shoqerise ka te drejte te vere ne rendin e dites problemin qe deshiron. Per kete duhet te informohen anetaret 3 dite perpara. Vendimet duhet te merren ne rastin kur jane present ortaket dhe kur nuk jane dakort duhet te pyetet nje person I trete I cili eshte specialist per problemin qe eshte ne diskutim dhe do te vendoset duke marre ne konsiderate dhe mendimin e specialistit.

TE DREJTAT E ASAMBLESE

Neni no.10

Miratimi I bilancit te shoqerise dhe ndarja e fitimit.

Emeron Keshillin Administrativ, administratorin, zevendesin, ekspertet dhe revizoret kontabel.

Percakton shperblimin per administratorët, ekspertet, revizoret kontabel.

Transferimi I kuotave te te trette.

Lidhja e kontratave per dhenie dhe marrie te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise.

Kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesemarrje ne tender, ankande ose aktivite te tjera te rendesishme.

Blerje, shitje si dhe tjetërsimi i pasurive te paluajtshme te shoqerise etj.

Modifikimi I kontrates se shoqerise.



Neni no.11

Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme. Asambleja mblidhet te pakten nje here ne vit, Brenda 4 muajve nga dita e mbylljes se veprimtarise. Ne kushte te vecanta Asambleja e zakonshme mund te mblidhet dhe Brenda 6 muajve nga dita e mbylljes se veprimtarise se shoqerise.

Asambleja e jashtezakonshme thirret me vendimin e saj kur Organi Administrativ e sheh te arsyeshme ose kur kerkohet nga ortaket qe perfaqesojne 10% te kapitalit te shoqerise. Ne kete rast Organi Administrativ ka te drejte te vendose ditën e mbledhjes jo me larg se 30 dite nga dita e kerkeses.

Neni no.12

Mbatja e vendimeve te Asamblese, process-verbalet dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te, duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

ADMINISTRIMI

Neni no.13

Shoqeria administrohet nga nje Administrator, I cili caktohet qe ne kontraten e themelimit te shoqerise dhe me pas nga Asambleja. Administratori qendron ne detyre nje vit dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme, paaftesi nga ana e Administratorit, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e tij duke treguar me fakte demin qe eshte shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem dhe nga specialistet perkates.

Asambleja mund te vendose lejimin e nje kompesimi ne favor te Administratorit per kryrjen e detyres pervec pagimit te shpenzimeve.

Aktualisht administrator i shoqerise eshte Z.Isuf Sukaj.


Z.Isuf Sukaj eshte gjithashtu dhe drejtuesi teknik I shoqerise.

Neni no.14

Administratori mund te emeroje nje ose me shume administratore te deleguar ose perfaqesues thjesht per te kryer veprime te vecanta dhe percakton fuqine Brenda kufijve duke respektuar statusin ne fuqi dhe ligjet gjithashtu, vendos dhenien e nje shperblimi ne favor dhe detyrat e tyre do te percaktohen me rregullore te brendeshme te shoqerise.

Neni no.15

Mbledhjet e keshillit te administrates behen ne qendren e shoqerise, por mund te behen dhe ne vende te tjera. Mbledhja duhet te behet te pakten 8 dite nga data e lajmerimit. Vendimet e Keshillit Administrativ quhen legale dhe te vlefshme kur votohet pro nga mazhoranca absolute e anetareve te Keshillit Administrativ. Ne rast barazimi fiton ai per te cilin kane votuar administratorët. Persa I perkete menyres se marrjes se vendimeve te Administratorit, per te do te zbatohen nenet e ligjes 7638 dt.19.11.1992.



Neni no.16

Administratori ka te drejte te nenshkruaj kontrata te ndryshme, oferta per gara kontratash, per furnizime publike, private, cdo lloj operacioni bankar (mbi kete shume vendos Asambleja e Ortakeve) te kreditoje me cdo lloj instituti bankar, publik e privat, te ndermarre veprime gjyqesore, transaksione te ndryshme etj. te gjitha te drejtat qe jane parashikuar ne ligj sipas nenit 50 te tij. Te formoje komisione ose komitete dhe me pjesemarrjen e te huajve dhe te caktoje nje drejtor te pergjithshem. Ky organ mund te japi prokura ne kufijte qe I lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.

MARDHENIET E PUNES

Neni no.17

Mardheniet e punes rregullohen ndermjet kontrates se punes dhe legjislacionit ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe t'i respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e saj te brendshme. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe I shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

SEKRETI I PUNES

Neni no.18

Konsiderohen si sekrete pune te gjitha aktet dhe dokumentat qe jane vendosur si te tilla nga administratoret e shoqerise.

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL


Neni no.19

Kontrolli mbi administratorin, veprimtarine e tij dhe gjithe aktivitetin e shoqerise I besohet nje ekspertit ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre aq sa percaktohet me ligj dhe edhte I rizgjidhshem. Asambleja cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

BILANCI DHE FITIMI

Neni no.20

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet me dt.31.12 te cdo viti. Organi Administrativ merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim humbje dhe inventar. Pas vecimit te fondeve si me siper dhe pagimit te detyrimeve fikse te ardhurat qe mbesin ndahen midis pronareve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkates ligjore.



Neni no.21

Ne rast se kapitali I shoqerise per shkak te humbjeve te reakizuara rezulton me pak se kapitali themeltar ,pronaret vendosin Brenda 4 muajve mundesine e prishjes se jashtezakonshme te shoqerise.

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni no.22

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsyeje Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit ,emeron nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentat e nevojshme per cregjistrimin e saj nga regjistri tregtar.

LIBRAT E SHOQERISE

Neni no.23

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e shoqerise.

1. Libri I Ortakeve
2. Libri I Mbledhjeve
3. Libri I Vendimeve te Administratorit
4. Libri I mbledhjeve dhe vendimeve te ruajtura per 10vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni no.24

Persa eshte shprehur ne kete statut I referohemi ligjit 7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare",statutit dhe rregullores se brendshme te shoqerise.Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre vete ky statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Per gjithcka tjeter qe nuk eshte permendur ne kete statut I referohemi legjislacionit ne fuqi.

Ky statut firmoset rregullisht nga ortaket e kesaj shoqerie.

ISUF SUKAJ

